

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E SHTËRPÇË
OPŠTINA ŠTRPCE
MUNICIPALITY OF SHTERPCE

Në bazë të dispozitave të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008 dhe nenit 18 dhe 161 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr.74/01 të datës 13.02.2004, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më 13.05.2008, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR LEJET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE AFARISTE**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1 – Objekti i rregullimit

Me Rregulloren për lejet për ushtrimin e veprimtarive afariste, përcaktohen :

- obligimet e subjekteve afariste për posedimin e lejeve për ushtrimin e veprimtarive afariste;
- kushtet dhe procedura e lëshimit të lejeve për ushtrimin e veprimtarive afariste;
- obligimet për zbatimin e rregullores;
- mbikqyrja inspektive dhe dispozitat ndëshkuese dhe
- procedura e ankesave .

**II. OBLIGIMET E SUBJEKTEVE AFARISTE PËR POSEDIMIN E LEJEVE PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE AFARISTE**

Neni 2 – Obliguesit

Subjektet afariste të regjistruara në Ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë për ushtrimin e veprimtarive të caktuara afariste, para fillimit të punës në territorin e Komunës së Shtërpçës duhet të paisen me Lejen për ushtrimin e veprimtarive afariste sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar me këtë Rregullore .

III. KUSHTET DHE PROCEDURA E LËSHIMIT TË LEJEVE

Neni 3 – Kushtet për lëshimin e lejeve për ushtrimin e veprimtarive afariste

Subjektet afariste për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarive afariste për objektin në të cilin ushtrojnë veprimtarinë e regjistruar afariste, duhet të prezantojnë këto dëshmi:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit në shiqim dhe një kopje të sajë
2. Dokumenti – Informatat mbi të dhënat e biznesit të regjistruar në shiqim dhe një kopje,
3. Dëshmia për pronësinë ose dëshmia për posedimin e objektit për ushtrimin e veprimtarisë afariste,
4. Dëshminë mbi certifikimin e objektit për plotësimin e kushteve tekniko, higjieniko – sanitare dhe kushteve tjera të parapara për ushtrimin e veprimtarisë,
5. Dëshminë mbi përmbushjen e obligimeve nga tatimi në pronë duke përfshirë objektin për të cilin kërkohet leja e punës ,
6. Dëshminë për pagesën e obligimeve të mbetura sipas Rregullores mbi tarifën, ngarkesat dhe gjokat komunale për periodën e posedimit të lejes së punës, përkatësisht të lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe
7. Provat përkatëse të cilat parashifën me dispozita ligjore dhe me rregulloret komunale për lejet për ushtrimin e veprimtarive të caktuara afariste.

Neni 4 – Parashtrimi i kërkesës

Kërkesa me dëshmitë përkatëse për lëshimin e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste për objektin në të cilin ushtrohet veprimtaria e regjistruar afariste i parashtrihet Drejtorisë për Ekonomi, Financa, Bujqësi dhe Pylltari.

Neni 5 – Lëshimi i lejeve për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe afatet e vlerëshmërisë

5.1 Drejtoria për Ekonomi, Financa, Bujqësi dhe Pylltari, sipas kërkesave të subjekteve afariste të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me dispozita ligjore dhe sipas rregulloreve komunale, për ushtrimin e veprimtarisë për objektin e caktuar afarist, nxjerr Aktvendim për dhënie të lejes së punës për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

5.2 Lejet do të lëshohen në kohëzgjatje si vijon :

- a) Për subjektet afariste të cilat merren me veprimtari tregtare konform dispozitave të Ligjit mbi Tregtinë e brendshme, të cilat kanë në pronësi objektet afariste, lejet do të lëshohen në kohëzgjatje të përherëshme, ndërsa nëse objektet afariste i shfrytëzojnë në bazë të Kontratës mbi qiranë lejet do të lëshohen në kohëzgjatje të Kontratës mbi qiranë.
- b) Për subjektet afariste të cilat merren me veprimtari tjera, lejet për ushtrimin e veprimtarisë afariste do të lëshohen: për objektet afariste të cilat i kanë në pronësi në kohëzgjatje të përcaktuar me dispozitat ligjore për ushtrimin e veprimtarive përkatëse , ndërsa për objektet të cilat i shfrytëzojnë në bazë të Kontratës mbi qiranë, në kohëzgjatje të Kontratës mbi qiranë, por jo më gjatë se kohëzgjatja e paraparë me dispozita ligjore dhe
- c) Për subjektet afariste të cilat sipas dispozitave ligjore posedojnë Licencën e punës, lejet do të lëshohen në kohëzgjatje të licencës .

5.3 Lejet e lëshuara nga paragrafet paraprake të këtijë neni, do të pushojnë të vlejnjë në rastet kur subjekti i biznesit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë e çregjistron veprimtarin afariste për objektin për të cilin është dhënë leja .

5.4 Drejtoria pwr Ekonomi, Financa, Bujqwsj dhe Pylltari do të nxjerrë Aktvendim për pushimin e lejes duke u bazuar në dëshmitë mbi çregjistrimin e veprimtarisë afariste pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për objektin për të cilin është dhënë leja dhe përmbushjes së obligimeve sipas Rregulloreve mbi taksat, tarifat dhe gjobat komunale,.

Neni 6 – Abrogimi i lejeve

Leja do të abrogohet me aktvendim të Drejtorisë pwr Ekonomi, Financa, Bujqwsj dhe Pylltari, në rastet kur subjekti afarist :

1. Në bazë të konstatimit të Inspektoratit – Inspektorit të tregut (financiar), ushtron veprimtari tjetër nga ajo për të cilën është dhënë leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe

2. Kur subjekti afarist nuk i paguan në afatin e paraparë dy kiste të obligimeve të përcaktuara në bazë vjetore për mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste sipas Rregulloreve mbi taksat, tarifat dhe gjobat komunale.

IV. OBLIGIMET PËR ZBATIMIN E RREGULLORES

Neni 7 – Obligimet e subjekteve afariste

7.1 Subjektet afariste janë të obliguara që gjatë ushtrimit të veprimtarisë të respektojnë dispozitat e parapara me këtë Rregullore.

7.2 Subjekti afarist është i obliguar që Aktvendimin për lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste ta vendos në një vend të dukshëm në objektin afarist.

Neni 8 – Obligimet e Drejtorisë pwr Ekonomi, Financa, Bujqwsj dhe Pylltari

8.1 Drejtoria pwr Ekonomi, Financa, Bujqwsj dhe Pylltari në zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset si vijon :

- a) të ofrojë ndihmë juridike subjekteve afariste për aplikimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje;
- b) të shqyrtojë kërkesat e subjekteve afariste për dhënien e lejeve dhe në procedurë të vendosjes në afatin prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës të nxjerr aktvendimin përkatës;
- c) në pajtim të dispozitave të nenit 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje do të nxjerr aktvendime mbi pushimin e vlerëshmërisë afatit dhe abrogimin e lejeve për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe
- d) të mbajë evidencë të posaqme të subjekteve afariste të cilat posedojnë leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste .

V. MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 9 – Mbikëqyrja inspektive

9.1 Mbikëqyrjen inspektive për zbatimin e kësaj rregulloreje do ta bëjw Sektori I Inspektoratit – Inspektori i tregut (financiar), I cili vepron nw kuadwr tw Drejtorisw pwr Ekonomi, Financa, Bujqwsu dhe Pylltari.

9.2 Inspektori i tregut (financiar) gjatë kontrollit inspektiv për subjektet afariste të cilat në territorin e Komunës ushtrojnë veprimtarinë pa leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste, me aktvendim do t'u tërhjëkë verejtjen që në afat prej 30 dite të paisen me leje.

9.3 Inspektori i tregut në rastet kur konstaton, se subjektet afariste të regjistruar në bazë të dispozitave ligjore në cilësi të personit fizik ose juridik, përkundër vërejtjes që të paisen me leje, në objektin e caktuar zhvillojnë aktivitetin afarist pa leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste, mund të ua ndalojë përkohësishtë ushtrimin e veprimtarisë deri në marrjen e lejes dhe do të ndërmerre masa tjera në pajtim me dispozitat ligjore dhe do të ushtrojë fletëparaqitje për kundravajtje në pajtim me dispozitat e nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

Neni 10 – Dispozitat ndëshkuese

Në bazë të fletëparaqitjes të Inspektorit të tregut do të gjorbitet për kundërvajtje:

a) në shumë prej 200 Euro pronari i subjektit të biznesit i regjistruar në cilësi të personit fizik i cili përkundër vërejtjes, përkatësishtë masës të shqiptuar në pajtim të nenit 9 par. 9.2 dhe 9.3 të kësaj Rregulloreje, për objektin përkatës, në afatin e përcaktuar nuk është paisë me leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste,

b) në shumë prej 500 Euro subjekti i biznesit i regjistruar në cilësi të personit juridik dhe në shumë prej 200 Euro personi përgjegjës i personit juridik i cili përkundër vërejtjes, përkatësishtë masës të shqiptuar në pajtim të nenit 9 par. 9.2 dhe 9.3 të kësaj Rregulloreje, për objektin përkatës, në afatin e përcaktuar nuk është paisë me leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

VI. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 11 – Parashtrimi i ankesave

11.1 Çdo subjekt afarist, në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën administrative, mund të parashtojë ankesë nëse është i pakënaqur në vendimin e nxjerrur në bazë të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 12 – Hyrja në fuqi

12.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Tabelën e shpalljeve, ndërsa do të aplikohet duke filluar nga data 01.04.2009.

12.2 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbi lejet e punës 01Nr. 526 e datës 29.06.2007.

INr. _____
Shtërpcë, më _____ 2009

KUVENDI I KOMUNËS SHTËRPCË

KRYESUESI I KUVENDIT
Radoica Mrdjinac

Arsyetimi

Miratimi i kësaj Rregulloreje është i bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të cilat i ushtron Komuna në pajtim të dispozitave të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, si dhe nenit 18 dhe 161 të Statutit të Komunës së Shtërpcës Nr.74/01 të datës 13.02.2004.

Poashtu, miratimi i kësaj Rregulloreje është i bazuar në dispozitat përkatëse ligjore, të cilat rregullojnë ushtrimin e veprimtarive të caktuara të biznesit , me të cilat është paraparë obligimi i subjekteve afariste që para fillimit të punës në objektet e punës të plotësojnë kushtet e caktuara teknike, higjeniko-sanitare dhe kushtet tjera si dhe përkitazi me këte të paisen me leje pune të cilën e lëshon organi kompetent i administrates komunale.

Përkitazi me këtë, me dispozitat e nenit 38 par.38.1 dhe par.38.3 të Ligjit mbi Tregtinë e brendshme Nr.2004/18 parashifet procedura për rregullimin e kushteve minimale teknike të cilat duhet ti përmbushin lokalet afariste dhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara parashifet kompetenca dhe obligimi i organit të administrates komunale për lëshimin e lejes së punës.

Poashtu duke u bazuar nw dispozitat e nenit 38 par.38.4 të Ligjit mbi Tregtinë e brendshme Nr.2004/18, me të cilën është paraparë që leja e punës për subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari nga lëmia e tregtisë, të jepet e përherëshme, si dhe duke u bazuar edhe në dispozitat tjera ligjore të cilat e rregullojnë kohëzgjatjen e lejeve të punës për veprimtaritë e caktuara afariste, në nenin 5 par.5.2 të kësaj Rregulloreje është propozuar që të harmonizohet kohëzgjatja e vlerëshmërisë të lejeve për ushtrimin e veprimtarive afariste.

Me dispozitat e nenit 72 të Ligjit për veprimtarin hoteliere dhe turistike Nr.2004/16 parashifet obligimi për lejen e punës të objektit hotelier të cilën e lëshon organi kompetent i administratës komunale.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura, në nenin 1 janë propozuar qështjet të cilat do të jenë objekt i rregullimit me këtë Rregullore.

Me dispozitat e nenit 12 të kësaj Rregulloreje propozohet hyrja në fuqi e Rregullores 8 ditë pas publikimit në Tabelën e shpalljeve si dhe shfuqizimi i Rregullores për lejet e punës të subjekteve afariste 01. Nr.526 e datës 29.06.2007.

Duke u bazuar në dispozitat e sipërcituara, propozoj që Kuvendi i Komunës të miratoj Rregulloren , ashtu si është propozuar në dispozitiv.

Shtërpçë, më 13.05 2009

KRYETARI I KOMUNËS
Stanko Jakovljevic

